



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6248 prot.

Ballsh më, 22 . 12 .2023

VENDIM

Nr. 66 Datë 21/12 2023

**PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË LANDFILLIT
TË MBETJEVE URBANE TË ADMINISTRUAR NGA AGJENCIA E ADMINISTRIMIT
TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA TIRANË**

Në zbatim të nenit 3, 8, 9, 14, 23, 32,33, 54 – gj, k), 55, pika 3 ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68, datë 27:04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër nr. 71, datë 20.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023” Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2008 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, shkresën me nr. 3080 Prot., datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe relacionit përkatës, me anë të së cilës propozohet marrja me qira nga ana e Bashkive të Qarkut Fier, vetëm të pjesës së landfillit të mbetjeve urbane, peshimit dhe rrugës hyrëse të Impjantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier,

VENDOSI

1. Dhënien e dakortësisë për Bashkinë Mallakastër për marrjen në përdorim me qira 1 (një) euro nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë vetëm të pjesës së landfillit të mbetjeve urbane, peshimit dhe rrugës hyrëse të Impjantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.
2. Dhënien e autorizimit për Kryetarin e Bashkisë Mallakastër, për të zhvilluar negociatat me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë për lidhjen e kontratës së qirasë, për pjesën takuese të Bashkisë Mallakastër në zbatim të pikës 1 të këtij projekt vendimi.
3. Dhënien e autorizimit për Kryetarin e Bashkisë Mallakastër për të zhvilluar negociatat me Bashkitë përbërëse të Qarkut Fier, të cilat depozitojnë mbetje urbane në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier, për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe përcaktimin e një strukture

të përbashkët, e cila do të kryejë për llogari të gjithë bashkive të Qarkut Fier, menaxhimin e pjesës së depozitimit, të peshimit dhe rrugës hyrëse në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.

4. Efektet financiare që nevojiten për funksionimin e strukturës së përbashkët menaxhuese, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për depozitimin, mirëmbajtjen, menaxhimin e landfillit (fuqi punëtore si dhe shpenzimet e përditshme operative) për pjesën takuese të Bashkisë Mallakastër, do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

5. Këto efekte financiare do të fillojnë të përballohen nga ana e Bashkisë Mallakastër pas momentit të marrjes në dorëzim të pjesëve të përshkruara më sipër nga Bashkitë e Qarkut Fier, që do të depozitojnë mbetjet urbane në impjantin e mbetjeve dhe lidhjes mes tyre të marrëveshjes së bashkëpunimit.

6. Në momentin e marrjes në dorëzim prej Bashkive të Qarkut Fier, të pjesëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, ndërpritet pagesa prej 1400 lekë /ton mbetje të depozituar e miratuar me VKB nr. 20, datë 26.04.2023 "Për miratimin e pagesës së depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Mallakastër në landfill".

7. Ky vendim shoqërohet me dokumentacionin bashkëlidhur.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

